

ditë më vonë, më **8.09.1998**, përderisa zhvillohej sulmi i forcave serbe mbi fshatin Beleg, Fetahu, Hedija, Lushi dhe një i afërm i tyre u nisën për në Isniq/Istinić. Në çastin kur ata u ndalën për të pushuar pranë shtëpisë ku jetonte Mala Vishaj, një predhë ka eksploduar shumë afër tyre dhe i ka qëlluar për vdekje Fetahun dhe Hedijen. Lushi dhe një i afërm i tij vetëm u plagosën. Po atë ditë, disa nga të afërmit e të vrrarëve i kanë bartur trupat e tyre në Krushec/Kruševac dhe i kanë varrosur në varrezat e atjeshme. Në datën 13.09.1999, familjarët i kanë transferuar mbetjet e tyre mortore nga Krusheci/Kruševac në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Prilep.

Burimi: deklaratat L.M, FDH-19226.

Shefqet (Curr) Zukaj

(5.02.1945, shqiptar nga Belegu/Beleg, komuna e Deçanit/Dečani, pjesëtar i UÇK-së)

Shefqeti aderoi në UÇK në fillim të luftës në rajonin e *Dukagjinit/Dukađini*. Mori pjesë në luftimet që i kanë përfshirë Prilepin/Prilep, Deçanin/Dečani dhe Carrabregun/Crnobreg. Në datën **8.09.1998**, Shefqeti ka rënë gjatë përleshjeve të armatosura me forcat serbe në vendlindje, në fshatin **Beleg**, ku edhe u varros.

Burimi: H. Hasani, *Dëshmorët...*, FDH-25596; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092; USCG KGDH, *Regjistri...*, FDH-8817; SMIP, *Teroristički...*, III,913; KMKKRF, *Personat...*, FDH-10832.

Halil (Bajram) Istrefaj

(6.10.1936, shqiptar nga Strellci i Epërm/Gornji Streoc, komuna e Deçanit/Dečani, bujk)

Halili ishte një person me nevoja të veçanta. Jetonte te djali i axhës, Rasimi, dhe familja e tij. Kur familjarët e tij me fshatarë të tjerë e braktisën **Strellcin e Epërm/Gornji Streoc** më **8.09.1998** dhe u strehuan në një bjeshkë mbi fshatin, Halili ka mbetur në Strellcin e Epërm/Gornji Streoc. Të nesërmen, Rasimi ka mësuar se pjesëtarët e forcave serbe e kishin vrrarë Halilin, përderisa ai kujdesej për bagëtinë në livadhin përkaj shtëpisë së Hasan Hoxhajt. E kishin qëlluar me plumba në kokë.

Familjarët e kanë varrosur Halilin në një fushë në pronë të familjes Istrefaj, më 9.09.1998. Ai prehet atje edhe sot.

Burimet: deklaratat R.I, FDH-16365; deklaratat NN, FDH-12285.

Muhamet (Bajram) Shala

(24.06.1961, shqiptar nga Prapaqani/Papracane, komuna e Deçanit/Dečani, shtëpiak, tre fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Muhameti punonte si mirëmbajtës në shkollën fillore *Jusuf Gërvalla* në Prapaqan/Papracane. Ka aderuar në UÇK menjëherë në fillim të luftës. Në datën **8.09.1998**, Muhametin e kanë plagosur kur forcat serbe e bombarduan **Prapaqanin/Papracane**. Nga plagët e rënda, Muhameti ka dhënë shpirt pas tri orësh në spitalin e UÇK-së në Krushec/Kruševac. E kanë varrosur në varrezat e Prapaqanit/Papracane.

Burimet: J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092; H. Hasani, *Dëshmorët...*, FDH-25596.

Sadri (Ramadan) Ukaj

(15.06.1927, shqiptar nga Ratişi i Ulët/Donji Ratiš, komuna e Deçanit/Dečani, bujk, dhjetë fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Isuf (Ramadan) Ukaj

(10.09.1926, shqiptar nga Ratişi i Ulët/Donji Ratiš, komuna e Deçanit/Dečani, bujk, nëntë fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Azem (Ramadan) Ukaj

(10.07.1933, shqiptar nga Ratişi i Ulët/Donji Ratiš, komuna e Deçanit/Dečani, bujk, shtatë fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Në datën 7.09.1998, nga ora 8.00, forcat serbe e filluan bombardimin e **Ratishit të Ulët/Donji Ratiš**. Civilët, kryesisht gratë dhe fëmijët, u arratisën nga fshati me nxitim. Në lagjen e Ukajëve mbetën 13 burra, në mesin e tyre edhe vëllezërit Sadriu, Isufi dhe Azemi. Që të gjithë ishin edhe në përbërje të shtabit të UÇK-së në Ratişin e Ulët/Donji Ratiš. Diku nga mesdita, forcat serbe kanë depërtuar në fshat me tanke dhe automjete të tjera të blinduara. Sadriu, Isufi dhe Azemi, si dhe burrat e tjerë të fshatit, u tërhoqën në pyllin e afërt, në vendin e quajtur *Kroni i Shpatit/Izvorski vrh*. Aty